Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Muhamet Kurtishaj	**06.04.2022**	**14.04.2022**	**Nr.88/22**
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 06.04.2022, OE **"GIGI" SHPK** ka parashtruar ankesën me nr.88/22, kundër vendimit për **anulim** të njoftimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me Kushineta"** me nr. te prok. KEK-21-8268-121**,** iniciuar nga autoriteti kontraktues **Korporata Energjetike e Kosovës.**
Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, **furnizim**, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **32.393,00 €.**
Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, më Nr.
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE të OE "GIGI" SHPK

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 1 i LPP - Qellimi
- Neni 6 i LPP – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 i LPP – Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskrirninirru
- Neni 56 i LPP – Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 59 i LPP – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 60 i LPP – Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 62 i LPP – Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta**.**
Më datën 23.03.2022 përmes platëformës së E-prokurimit kemi pranuar LETER Standarde per Tenderuesin e Eleminuar dhe vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit. AK-es anuloi aktivitetin e prokurimit me arsyetimin të plotësimit apo ndryshimit të specifikimit teknik ndërsa neve si Operator na eliminoi për këtë arsye:

Pas kontrollimit të detajuar të dosjes se tenderit dhe specifikimit teknik të detyrueshëm konstatohet se te Poz.6 Kushineta 6328 2Z C3 është bëre gabim teknik dhe duhet te jetë :
Poz.6 kushinetë 6328 C3 standardi DIN 625-1
Rrjedhimisht për Poz.6 na duhet kushineta pa mbyllëse të boshllëqeve në të dy anët .

Ne si OE bëmë Kërkesën për Rishqyrtim pranë AK-es por rezultoi me vendimin e Autoritetit kontraktues si e pa bazuar.
Siç Siç provuam të shpjegojmë pran AK-es në kërkesën për rishqyrtim që oferta jonë ishte e saktë, e qartë,

korrekte dhe më e lira konform kërkesave të dosjes së tenderit edhe këtu do të ofrojmë shpjegimet shumë të sqaruara lidhur me shkeljet që n'a janë bërë neve si OE lidhur me aktivitetin në fjalë.
Në DT-it janë kërkuar 9 pozicione të ndryshmë të kushinetave përfshirë edhe pozicionin e gjashtë "6328 2Z C3". Të gjashtë pozicionet e para janë kërkuar të jenë me sufikset(prapashtesat pas numrin te kushinetës) 2Z C3 dhe kjo "2Z" tregon që kushineta ka dy mbyllëse anësorë në mënyrë që ta mbrojë yndyrën të qëndrojë brenda sferave të kushinetës.Kushineta me këto Mbyllëse montohet në ato raste kur vendi ku instalohet kushineta nuk ka mundesi të lubrifikohet me vaj apo yndyrë dhe për këtë arsye kërkohen kushineta me yndyrën e vetë dhe me mbyllëse për ta ruajtur lubrifikimin brenda sferave të kushinetës. Nëse vendi i instalimit është më vaj apo me mundësi të lubrifikohet më yndyrë atëherë gjatë instalimit kushinetës mund ti hiqet mbyllëset pa asnjë problem dhe të montohet edhe pa mbyllëse. Ne konstatojmë që refuzimi i ofertës tonë nga AK-es për shkak të këtyrë mbyllëse është edhe qesharak sepse nëse njëmend i nevojitet AK-es ky pozicion pa mbyllëse (pa 2Z) atëhere krejt çka u duhet është të ja heqin mbyllësen dhe ta instalojnë kushinetën.
Ne duke konsideruar që vlerësimin e ofertës tonë e ka bërë ndonjë komision apo anëtar i komisionit që nuk ka njohuri elementare me funksionimin dhe instalimin e kushinetave do të domostrojnë komponentet e kushinetës 6328 2Z C3 dhe cilido person që mund të jetë edhe jashtë fushës profesionale mund të kuptojë që arsyeja e refuzimit të ofertës tonë është absurde dhe tashmë jemi edhe të bindur që është e qëllimshme . Më poshtë shihni figurën_1



Figura 1.

Siç mund të shihni në figurën_1 të mësipërme saktësisht ju domostrojmë edhe elementet e kushinetës por edhe funksionin e tyre.

Më Poshtë ne po ju dërgojmë edhe praktikisht si është hequr mbyllësja e kushinetës dhe si mund të hiqni nëse vërtet ju duhet pa mbyllëse, shih figuren_2:

Në figurën 2 saktësisht mund të shihni si i është hequr mbyllësja dhe tani kushineta mund të montohet ashtu siç thoni ju pa mbyllëse. Ne ju ofruam edhe shpjegimin e mësipërm duke konsideruar që në komision vlerësues nuk ka qenë ndonjë person nga njësia kërkuese e montimit por mund të kenë qenë vetëm anëtërë tjerë jashtë fushës profesionale sepse ndryshe edhe shpjegimi jonë nuk do të kishte kuptim sepse këto janë njohuri elementare që çdo montues apo instalues i kushinetave i din apo duhet t'i dijë.
Përveq anës që shpjeguam edhe sikur kjo kushinetë nuk do të mund të instalohej në vendin e punës prap se prap aktiviteti i prokurimit lidhur me këtë nuk mund të anulohej sepse bie ndesh dhe është në kundërshtim me shumë nene të ligjit të Prokurimit publik.Ne përmendëm me lartë shumë nene por këtu do t'i veçojmë vetëm më kryesorët. Neni 56 pika 3 thotë:
E shihni që AK-es ka bërë shkelje të këtij neni sepse kërkesë në DT-it ishte kushinetë 6328 2Z C3 dhe ne kemi ofertuar konform asaj kërkese dhe AK-es tani nuk mund të përjashtojë apo diskualifikojë ofertën tonë.
Neni 59 pika 1 thotë:
"Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"
Lidhur me Nenin 59 pikën 1 sqarohet se anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë veç e veç. Atëherë ne kërkojmë përgjegjësinë e anëtarit ose anëtarëve që kanë shkelur ligjin e prokurimit publik gjatë vlerësimit të ofertës sonë. Bazuar në të dhënat e shënuara më lartë është shumë e kuptueshme se oferta e kompanisë sonë është oferta e pergjegjëshme si nga aspekti teknik po ashtu edhe nga aspekti administrativ dhe se i plotëson të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues të paraqitura në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë. Pasi që oferta jonë është ofertë e përgjegjshme , konsiderojmë se vendimi për anulim të aktivitetit nga AK-es është në kundërshtim të plotë me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik. Nëse i referohemi përshkrimit të nenit të LPP shihet se asnjë nga kushtet e këtij neni të LPP nuk është plotësuar që të përfundohet aktiviteti i prokurimit. Oferta jonë është oferta me çmim më të lirë nga ofertat e përgjegjshme,prandaj është obligim i Autoritetit kontraktues që të zbatoj kriterin e dhënies së kontratës për këtë aktivitet të prokurimit dhe lenda të kthehet në rivlerësim dhe të na shpërblej me kontratë ,e jo të anuloj aktivitetin e prokurimit.
Prandaj kërkojmë nga OSHP që pas shqyrtimit të Ankesës tonë dhe verifikimit të fakteve të ofruara si dhe çdo herë duke u mbështetur në parimet dhe dispozitat e LPP-së, të marrë:

VENDIM

APROVOHET e bazuar Ankesa e OE GiGi SHPK " nga Prishtina lidhur me tenderin "Furnizim me kushineta" i iniciuar nga KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.
ANULOHET vendimi i AK- KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a. për Anulimin e aktivitetit te prokurimit dhe lenda të kthehet në rivlerësim e kjo të bëhet duke u bazuar plotesisht në kerkesat e dosjes së tenderit dhe dipozitat e LPP-së

KRITERET PËR VLERËSIM

Te vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore.

Arsyet per eliminimin e OE ankues eshte bere per shkak te anulimit te aktivitetit te prokurimit me arsyen se duhet te ndrrohet specifikimi teknik i nje artikulli ne nje pozicion per shkak se eshte vrejtur nje gabim ne baze te cilit nuk munden te pranohen artikuj te tille.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës se OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Komisioni i vlerësimit pas kontrollimit dhe verifikimit te ofertave konkurruese, ka ardhe ne përfundim se aktiviteti i prokurimit duhet te anulohet me qellim qe te përmirësohet specifikimi teknik ne nje artikull.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Nuk ka marre eksperti shqyrtues informacion shtese.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

OE ankues është pale e interesit ne këtë aktivitet te prokurimit**.**

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjti është dhënë vlerësim tjetër).

Nuk ka pasur vendim te me hershem për këtë aktivitet te prokurimit**.**

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

Nuk kemi devijim nga praktikat e me hershme.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "GIGI" SHP

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Pretendimi i OE ankues eshte se AK e ka anuluar aktivitetin e prokurimit ne kundërshtim me dispozitat e nenit 62 të LPP-se me arsyetim të plotësimit apo ndryshimit të specifikimit teknik, respektivisht pozicionit nr.6 Kushineta 6328 2Z C3 eshte bere gabim teknik dhe duhet te jete kushinete 6328C3 standardi DIN 625-1 , ne konstatojmë që refuzimi i ofertës tonë nga AK-es për shkak të këtyre mbyllëseve është edhe qesharak sepse nëse njëmend i nevojitet AK-es ky pozicion pa mbyllëse (pa 2Z) atëhere krejt çka u duhet është të ja heqin mbyllësen dhe ta instalojnë kushinetën. Lidhur me kete pretendim, eksperti shqyrtues ka kete mendim.

Anulimi i aktivitetit te prokurimit me qellim te ndryshimi/plotësimit te specifikimit teknik apo dosjes se tenderit ne përgjithësi, ne fazën e vlerësimit te ofertave nuk lejohet me asnjë dispozite te nenit 62 te LPP-se. Nese AK ka vrejte se ndryshimi i specifikimit teknik eshte i nevojshëm per ndonjë arsye te caktuar te tyre apo si rezultat i kerkesave te OE, atëherë ndryshimi/plotësimi ka qene dashte te behet ne fazën e marrjes se dosjes se tenderit, respektivisht para hapjes se ofertave ashtu siç parashihet me paragrafin 3.3 te nenint 108/A te LPP-se.

Arsyetimi i AK, se ne formën siç eshte kërkuar Kushineta ne pozicionin nr.6 eshte bërë gabim teknike nga AK, kjo nuk eshte bindes edhe ne aspektin teknik per ekspertin shqyrtues. Meqenëse kushinetat munden te perdoren edhe pa mbylleset (2Z) ne mënyrën siç eshte kerkuar ne specifikimin teknik te dosjes se tenderit, atëherë anulimi i aktivitetit te prokurimit nuk eshte i arsyeshme por edhe ne kundërshtim me nenin 62 te LPP-se. Prandaj eleminimi i ofertës se OE ankues pa asnjë arsyetim me qellim te anulimit te aktivitetit te prokurimit bie ndesh edhe me dispozitat e nenit 59 te LPP-se. Mbi kete baze ky pretendim ankimor vlerësohet si i **bazuar**.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Autoriteti kontraktues ka bere anulimin e aktivitetit me arsyetimin se duhet te bere plotësim /ndryshimi i specifikimit teknik per artikullin ne pozicionin nr. 6. Procesit i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit te tenderëve nuk është bërë ne perputhje me nenin 59 te LPP-se sepse oferta e OE ankues eshte eleminuar pa asnjë arsyetim ligjore. Plotesim ndryshimi i specifikimit teknik ne dosjen e tenderit ka mundur te behet para hapjes se ofertave, nëse ka qene e nevojshme. Ndryshimet e dosjes se tenderit nuk munden te behen ne fazën e vlerësimit te ofertave. Po ashtu arsyet e plotësim ndryshimit te specifikimit teknik, nuk janë bindese per mendimin e ekspertit shqyrtues sepse artikulli ne fjale eshte funksionale edhe ne formën siç eshte kërkuar nga AK. Me anulimin e aktivitetit te prokurimit nuk janë respektuar dispozitat e nenit 62 te LPP-se (përfundimi i aktivitetit te prokurimit)

Eksperti shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit te pretendimit ankimor i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues "GIGI" të **aprovohet** si e bazuar.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të bëjë **Rivlerësimin** e ofertave për aktivitetin e prokurimit **"Furnizim Kushineta"** me nr. te prok. KEK-21-8268-121 në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues KEK,
- Panelit Shqyrtues OSHP dhe
- OE ankues"GIGI" SHPK